

Data \_\_\_\_\_

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje Materiale Kancelarie”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**30190000-7**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

Fondit limit **1,682,775** (një milion e gjashtëqind e tetëdhjet e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjet e pesë) **lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Tirana Parking ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës nr 3.;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit nr 8*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit

.....  
(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 2 vitet e fundit financiare 2021-2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % i vlerës i vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

**Argumentimi:** Referuar nenit 43, pika 2, paragrafi c), dhe pika 3, të VKM nr. 285 date 19.05.2021.

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me ane të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomike të deshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së perlloritur të kontratës, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me çertifikate sipas standartit të sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalent të vlefshme.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon 1 (një) automjet që do të shërbejë për transportin e produkteve objekt prokurimi, në pronësi ose në përdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon 1 (një) automjet, në pronësi ose në përdorim sipas kontratës noteriale, të vërtetuar me:

- leje qarkullimi,
- çertifikate pronësie
- siguracion (TPL)
- çertifikatë e kontrollit teknik

Në rastin kur automjeti është në qera/në përdorim, të paraqesë kontratën noteriale përkatëse si dhe dokumentat e kërkuara të automjetit.

- **Argumentimi:** Kriteri që OE ku të deklarojë se disponon 1(një) automjet që do të shërbejë për transportin e produkteve objekt prokurimi, është vendosur në funksion të zbatimit të kontratës për procesin e lëvrimin të mallit në magazinën e AK, sipas grafikut të lëvrimin.

2.3.4 Ditën e hapjes së tenderit, Operatorët ekonomikë konkurues duhet të paraqesin një mostër sipas specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor për artikujt e mëposhtëm:

| Nr. | Emërtimi i artikullit  | Njësia | Sasia |
|-----|--|--------|-------|
| 1   | Letër kase 57 x 33 mm (me shirit të kuq për sinjalizimin e fundit të stokut) | Copë   | 1     |
| 2   | Letër kase 80 x 55 mm (me shirit të kuq për sinjalizimin e fundit të stokut) | Copë   | 1     |

**Mungesa e mostrës është kusht skualifikues.**

- **Argumentim:** AK ka kërkuar që ditën e hapjes së tenderit, OE konkurues duhet të paraqesin një mostër sipas specifikimeve teknike, për disa nga artikujt e listës objekt prokurimi. Kjo kërkesë është vendosur referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 40, pika 6/a. Artikujt për të cilët kërkohet mostër janë përzgjedhur në raport me karakteristikat specifike që ato kanë si dhe në raport me sasinë dhe vlerën që ato zënë në listën e përgjithshme të artikujve objekt prokurimi.

#### **I. Argumentim për hartimin e specifikimeve teknike:**

Për hartimin e specifikimeve teknike komisioni ju është referuar kërkesave të institucionit për llojin, tipin, përmasat dhe të dhënat teknike specifike të secilit artikull që kërkohet.